



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:054013 C. nr. 433/2021
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05514745

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.G.B. nga fshati.... Komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson F.S.- Gjilan, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Prizren, me objekt kontesti kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 664.91 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e nëntëdhjetë e një cent), jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 27 Mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses D.G.B. nga fshati Komuna e Suharekës, me të cilën ka kërkuar që të: *“Detyrohet e paditura Sh.S.K.U.K. – Qendra Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Prizren, që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar të i paguajë (kompensojë) një (1) paga mujore neto, në shumën prej 664.91 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjyqimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm”*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja D.G.B. nga fshati Komuna e Suharekës, përmes të autorizuarit të saj avokat F.S. nga Gjilani, pranë kësaj gjykate, me datën 23 Mars 2021, ka parashtuar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 664.91 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e nëntëdhjetë e një cent).

Në referatin e padisë i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mjeke – Specialiste e Psikiatrisë në Fëmijëve në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren, mbi 10 vite përvojë pune. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, konkretisht, nenit 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, paditësja i është drejtuar të paditurës si punëdhënëse me kërkesë që t’ja paguaj shpërblimin jubilar për punë mbi 10 vite. E paditura përkundër faktit se e ka pranuar kërkesën verbale të paditësit, përveç premtimeve se këtë pagesë do ti paguaj pas rishikimit të buxhetit, e njëjta deri më tani asnjëherë nuk i kanë paguar. Duke shtuar se kërkesa e paditëses mbështetet në Kontratën Kolektive Sektoriale në nenin 17 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 për shpërblim jubilar në vlerë të një page mujore të tij 664.91 euro, pasi që vlera e një page mujore e paditësit është 664.91

euro, ku njëherit i propozon gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, taksën për padi 20.00 euro, gjithsej në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi përkundër faktit se e njëjta vërejtjen për parashtrimin e përgjigjes në padi e ka pranuar më datë 15.11.2021.

Me vlerësimin e gjithanshëm të të gjitha provave të administruara, fakteve të vërtetuara, veçmas secilën si dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata ka vlerësuar provat e bashkangjitura në padi si kontratën e marrëdhënies së punës me nr.të kontratës 1292 dhe titull të postit H-20, e lidhur mes këtu paditëses D.G.B. dhe të paditurës Sh.S.K.U.K. vërtetimin me nr. 10/51, të datës 08.10.2015, dhe listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Për gjykatën nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune, i caktuar në vendin e punës si mjeke – Specialiste e Psikiatria e Fëmijëve në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren, dhe e njëjta pranë të paditurës është pranuar në marrëdhënie të punës në kohë të pacaktuar në cilësi Psikiatre e fëmijëve në Shërbimet e Shëndetit Mendor në Prizren, duke filluar prej 01.04.2015, fakt ky që u provua edhe përmes vërtetimit të punësimit, e lëshuar nga e paditura me nr. 10/51, të datës 08.10.2015, përvojën e punës në të cilën thirret në padi paditësja, e njëjta nuk e ka arritur.

Gjykata duke analizuar provat e bashkangjitura padisë, e më saktësisht vërtetimin mbi përvojën e punës të lëshuar nga e paditura, vërtetoi faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura si mjeke – Specialiste e Psikiatria e Fëmijëve në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren, më datë 01.04.2015. Nga kërkesa e palës paditëse shihet se e njëjti ka kërkuar që t'i paguhet një (1) paga jubilarë, në lartësi prej 664.91 euro, për 10 vite përvojë pune. Me nenin 17 par. 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë është paraparë “Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1; për 10 vjet të përvojës në punë institucione shëndetësore në vlerë të një page mujore të tij, 3.2; për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij, 3.3; për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”. Ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është përcaktuar se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Nga përshkrimi i dispozitës në fjalë dhe Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023 pika IX shihet se për të pasur të drejtë në kompensimin e pagave jubilarë duhet të përmbushen vitet jubilarë të përvojës së punës tek punëdhënësi i fundit dhe të parashtrohet kërkesa brenda periudhës kohore të fushëveprimit të kontratës kolektive. Nga të gjitha këto gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e palës paditëse për shpërblimin e një page jubilarë për 10 vite të

përvojës së punës tek punëdhënësi i fundit është e parakohshme, pasi që për të realizuar këtë kërkesë duhet të ketë pasur 10 vite përvojës së punës e në rastin konkret paditësja nuk e ka arritur për faktin se e njëjta marrëdhënie e punës e ka themeluar më datë 01.04.2015.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 433/2021, me datë 27 Mars 2023

B. Profesional.

Gjyqtari

Ilir Sërtollaj

Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.